Kontrata duhet të përmbajë përshkrimin e vendit të punës dhe detyrimin e personelit akademik, sipas përcaktimeve të pikës 1 të nenit 47 të ligjit të mësipërm. Kontrata nënshkruhet nga i punësuari dhe Rektori. Pas përfundimit të kontratës dhe plotësimit të kushteve të saj, për punonjësit me gradë shkencore, kontrata mund të kthehet në definitive. Punonjësit pa gradë shkencore mund të merren vetëm me kontratë të përsëritshme deri në 3 vjet.

- Pedagogët e ftuar, pasi rezultojnë fitues në konkurs, merren me kontratë njëvjeçare.

- Punonjësit akademikë të ftuar propozohen nga departamenti në bazë të nevojave të tyre dhe miratohen nga dekani i fakultetit dhe Rektori i Universitetit.

- Punonjësit mësimorë të huaj pranohen në procesin mësimor me propozim të dekanit dhe vendim të Senatit të Universitetit.

Në përfundim të procedurave të rekrutimit të stafit të ri akademik, materialet informative (njoftimet për punë), dosjet e plota të kandidatëve që kanë aplikuar dhe atyre që janë shpallur fitues, vendimet e marra nga komisionet e fakulteteve dhe vendimet e Senatit depozitohen të gjitha pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, Komunikimit dhe Promocionit.

Pedagogët e brendshëm dhe të ftuar përzgjidhen në bazë të dosjes individuale të aplikimit (dokumentacionit të kualifikimeve profesionale). Për përzgjedhjen e kandidatëve vendos Rektori i Universitetit (që ka edhe cilësinë e punëdhënësit), i cili mund të tërheqë sipas rastit mendimin e Dekanit të Fakultetit apo Përgjegjësit të Departamentit, ku kandidati aplikon.

Kriteret që duhet të përmbushin kandidatët për pedagogë përcaktohen nga departamenti për të cilin aplikon kandidati, në përputhje me legjislacionin në fuqi për arsimin e lartë dhe miratohen nga Dekani i Fakultetit.

Pedagogët e huaj pranohen në bazë të marrëveshjeve dypalëshe.

Dosjet e personelit akademik të brendshëm dhe administrativ kanë në përbërje dokumentacionin e mëposhtëm:

- Dokumentin e identitetit (fotokopje e pasaportës ose kartës së identitetit);
- Dokumentin që vërteton punën e kryer më parë (librezë pune ose vërtetim nga punëdhënësi i mëparshëm);
- Librezën e sigurimit shoqëror e shëndetësor;

- Diplomën e shkollës së lartë dhe listën e notave;
- Kualifikimet e tjera profesionale (brenda ose jashtë vendit);
- Gradat shkencore apo titujt akademikë;
- Raportin mjekësor për aftësimin në punë ose librezën shëndetësore, lëshuar nga inspektoriati sanitar shtetëror;
- Adresën e vendbanimit ose ndonjë dokument tjetër të nevojshëm, sipas specifikës së vendit të punës.

E gjithë procedura pasqyrohet në statutin e UK “Fan S. Noli”. (Të gjitha këto të dhëna gjenden tek Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Komunikimit dhe Promocionit në Universitet).

f) Shkalla e kualifikimit të stafit kryesor;

Të dhëna për personelin e njësisë sipas klasifikimit të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, Komunikimit dhe Promocionit.

Grada shkencore	Fakulteti i Bujqësisë	Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë	Fakulteti i Ekonomisë	Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane	Gjithsej
Prof. dr.	1	1	-	2	4
Prof. as. dr.	10	8	14	1	33
Doktor	6	25	8	15	54
PhD.	-	4	1	2	3
Docent	1	4	1	2	7
MSc.	5	7	10	29	51
Gjithsej	22	49	34	51	156

g) Raporti staf i kualifikuar, staf i pakualifikuar;

76.5 % e stafit është kualifikuar, ndërsa 23.5% është e pa kualifikuar (ku pjesa më e madhe prej tyre është në proces doktrate)

Raporti staf i brendshëm, staf i jashtëm 75% e stafit është i brendshëm dhe pjesa tjetër 25% është i jashtëm.

h) Mosha mesatare e stafit mësimdhënës dhe raporti meshkuj-femra.

Raporti meshkuj/femra në %:

Meshkuj/Femra	Fakulteti i Bujqësisë	Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë	Fakulteti i Ekonomisë	Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane	Gjithsej
Meshkuj	17	13	6	18	54
Femra	5	36	28	33	102

i) Të dhëna për shpërndarjen e stafit akademik të brendshëm sipas moshës.

	STAFI AKADEMIK - ME KOHË TE PLOTË									
FAKULTETI	Mosha nën 25 vjet	25-29	30-34	35-39	40-44	45-49	50-54	55-59	60-64	65 e lart
FAKULTETI I EDUKIMIT DHE FILOLOGJISË		2	12	10	8	6	2	2	3	1
Departamenti i Gjuhë Letërsisë			2	1	1	6			1	
Departamenti i Gjuhëve të Huaja			4	3	4				1	
Departamenti i Histori-Gjeografisë		1	4	3	2					1
Departamenti i Edukimit			2		1		2	2	1	
FAKULTETI EKONOMIK		2	3	7	10	6	2	2		
Departamenti Financë - Kontabilitet		2	3	3	4	1	1	1		
Departamenti i Menaxhimit				1		4	1	1		
Departamenti Marketing Turizëm				3	6	1				
FAKULTETI I BUJQESISË			3	5	1	1	2	2	3	1
Departamenti i Agronomisë				1		1	1	1	1	
Departamenti i Agrobiznesit			1	3	1		1	1		

Departamenti i Agroushqimit			2	1					2	1
FAKULTETI I SHKENCAVE NATYRORE DHE HUMANE	1	6	18	8	4	7	3	3	1	
Departamenti i Matematikës, Informatikës dhe Fizikës	1	3	7	2		4	2	2		
Departamenti i Shkencave Sociale		1	7	2	1	1			1	
Departamenti i Infermierisë			2	3	2	2	1	1		
Departamenti Biologji Kimi		2	2	1	1					

- j) Realizimi i orëve të pedagogëve efektivë dhe të ftuar për vitin akademik 2016-2017 sipas departamenteve.

Ngarkesa për çdo departament të pedagogëve	Efektivë	Të ftuar
Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë	18713	2513
Departamenti i Edukimit	3781	737
Departamenti i Gjuhë Letërsisë	4250	281
Departamenti i Gjuhëve të Huaja	6516	1495
Departamenti i Histori-Gjeografisë	4166	
Fakulteti i Bujqësisë	9021	759
Departamenti i Agrobiznesit	2731	759
Departamenti i Agronomisë	3164	
Departamenti i Agroushqimit	3126	
Fakulteti Ekonomik	14047	331
Departamenti Financë - Kontabilitetit	5351	84
Departamenti Marketing -Turizëm	4527	247
Departamenti i Menaxhimit	4169	
Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane	23843	5009
Departamenti i Biologji-Kimisë	3152	
Departamenti i Matematikës, Informatikës dhe Fizikës	9291	1452
Departamenti i Shkencave Sociale	6036	1089
Departamenti i Infermierisë	5364	2468

VII.KËRKIMI SHKENCOR

Angazhimi në veprimtarinë kërkimore-shkencore dhe kualifikimi i vazhdueshëm janë pjesë e rëndësishme e punës së pedagogut. Rritja e cilësisë së mësimdhënies ka për bazë dhe arrijtet në punët kërkimore-shkencore të realizuara nga stafi akademik i Universitetit. Realizimi i studimeve dhe punëve shkencore duhet të jetë i zbatueshëm dhe praktik dhe në funksion të kurrikulës ose të përdoret si pjesë e literaturës përkatëse në çdo disiplinë.

a) Kërkimi shkencor;

Tabela përmbledhëse për rezultatet e periudhës Shtator 2016-Shtator 2017

		SIPAS FAKULTETEVE TË:			
Nr.	EMËRTIMI	BUJQËSISË	EDUKIMIT DHE FILOLOGJISË	EKONOMISË	SHKENCAVE NATYRORE DHE HUMANE
1.	Projekte (pjesëmarrje)	18	15	5	-
2.	Konferenca Ndërkombëtare	36	74	13	55
3	Konferenca kombëtare	2	10	-	
4.	Simpozium	1	2	-	-
5.	Seminar	2	4	-	-
6.	Lektorium	2	5	3	7
7.	Workshop	6	10	-	10
8.	Tekste	-	2	7	2
9.	Monografi	-	1	-	1
10.	Dispensa	4	-	-	8
11.	Artikuj	16	43	11	43
12.	Publikime	15	14	9	7

b) Kualifikimi shkencor.

Mbrojtja e gradave dhe titujve shkencorë

TITUJT/GRADAT	FAKULTETI I BUJQËSISË	FAKULTETI I EDUKIMIT DHE FILOLOGJISË	FAKULTETI I EKONOMISË	FAKULTETI I SHKENCAVE NATYRORE DHE HUMANE
Doktor	2	7	4	1
Prof. as. dr.	-	-	-	-
Prof. dr.	-	-	-	-

VIII. STUDENTËT

a) Kriteri i pranimi të studentëve;

Kurset e studimit zhvillohen në bazë të planit mësimor të miratuar në Këshillin e Fakultetit dhe më pas në Senatin Akademik në Universitet.

Për të siguruar një formim sa më bashkëkohor të studentëve planet mësimore janë rinovuar çdo vit, duke ruajtur një raport të pranueshëm midis grup lëndëve të formimit të përgjithshëm, formimit bazë, formimit special dhe lëndëve me zgjedhje.

b) Zhvillimi i studimeve;

Plani mësimor dhe kurrikulat e Fakulteteve të Universitetit “Fan S. Noli” u mbështetën në rregulloret mësimore të secilit prej programeve të studimit. Për çdo programi studimi departamentet kanë hartuar rregulloren mësimore në përputhje me planin mësimor, duke respektuar lirinë akademike, si dhe të drejtat dhe detyrimet e personelit akademik dhe të studentëve.

Rregullorja mësimore e një programi studimi përcakton në veçanti:

- listën e disiplineve mësimore, të ndara në module si dhe veprimtari të tjera formuese;
- objektivat formues specifikë të çdo disipline apo veprimtarie tjetër formuese;
- kreditet dhe detyrimet penguese për çdo disipline mësimore apo veprimtari tjetër formuese;
- kurrikulat që u ofrohen studentëve;
- format e studimit, të provimeve dhe verifikimeve të tjera të dijeve të fituara nga studentët;
- detyrimet e mundshme që lidhen me frekuentimin;
- kushtet për procedurat dhe modalitetet për transferimin e studentëve.

Këto kurrikula përsosën dhe pasurohen në mënyrë të vazhdueshme me të reja bashkëkohore në fushat përkatëse. Në planin mësimor të çdo programi studimi është synuar të ruhet një raport i drejtë midis formimit të përgjithshëm, formimit bazë dhe atij profesional të studentëve për të gjitha nivelet.

Objekti kryesor i programeve të studimit është t’u japë studentëve njohuritë e nevojshme dhe bazë për formimin e tyre profesional, si dhe kërkimit shkencor.

Sistemi i njohurive që ofrohet nga programet e studimit dhe kompetencat që përftojnë studentët nëpërmjet tyre u mundësojnë atyre edhe ndjekjen e një karriere kërkimore apo akademike nëpërmjet vazhdimi të studimeve të ciklit të dytë, pra studimet në nivel “Master” duke rritur kështu mundësinë e karrierës së tyre profesionale.

Departamentet e këtij Fakulteti kanë punuar për përgatitjen e programeve për ciklin e dytë (programet Master) të studimeve.

c) Vlerësimi i studentëve;

Procedura e vlerësimit të studentëve është e publikuar në Rregulloren e studimeve në Universitetin e Korçës (në kreun IV) të saj dhe bazohet në dy përbërës:

1. vlerësimi i vazhdueshëm;

2. provimi përfundimtar.

Raporti midis tyre është përkatësisht 30% me 70%. Veprimtaria mësimore vërtetohet në dokumentacionet përkatëse, si regjistri i pedagogut, libri i regjistrimit të studentëve, amza e notave, procesverbalet e zhvillimit të provimeve, libri i dorëzimit të diplomave etj.

d) Praktika profesionale;

Universitetit “Fan S. Noli” ka marrëveshje bashkëpunimi me institucionet publike dhe private të ndara sipas profilit të fakulteteve dhe programeve të studimit që ofrojnë, për kryerjen e praktikave mësimore të studenteve tanë. Në këto institucione studentët zhvillojnë aftësitë praktike të njohurive teorike të përfituara në orët e leksioneve në auditor.

e) Mbrojtja e diplomës;

Diplomimi në nivelin Bachelor kryhet në dy forma,

1. me provim formimi;
2. me mbrojtje teze diplome (nga studentë me rezultate të mira);

Në fund të studimeve studenti pajiset me diplomë të nivelit Bachelor sipas profilit përkatës dhe suplementin e saj në gjuhën shqipe dhe angleze (referoju Rregullores së studimeve në UK “Fan S. Noli”, kreu VII).

Në përfundim të ciklit të dytë të studimeve studenti pajiset me diplomën e nivelit Master në programin përkatës të studimit.

f) Gjeografia e pranimi të studentëve;

Viti akademik 2016-2017			
FAKULTETET	Zonat rurale	Zonat urbane	Gjithsej
Fakulteti i Bujqësisë	72	71	143
Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë	101	284	358
Fakulteti i Ekonomisë	157	173	330
Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane	212	327	539

g) Shpërndarja gjeografike e pranimi të studentëve sipas programeve të studimit për vitin akademik 2016 – 2017;

<i>FAKULTETET</i> \ <i>RRETHET</i>	KORÇË	DEVOLL	KOLONJË	POGRADEC	LIBRAZH	GRAMSH	SKRAPAR	TIRANË	TJETER
Fakulteti i Bujqësisë	88	22	6	22	-	2	-	1	2
Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë	217	37	18	82	7	1	-	2	19
Fakulteti i Ekonomisë	226	33	11	39	7	2	-	-	10
Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane	380	29	13	79	-	1	1	1	35
Gjithsej	911	121	48	222	14	6	1	4	66

IX.BURIME MATERIALE/LOGJISTIKA

Universiteti “Fan S. Noli” ka një infrastrukturë moderne laboratorike, salla me video projeksion, salla video konferencash, salla departamentesh, 4 (katër) biblioteka në fakultete dhe 1 (një) bibliotekë universitare, mbi 300 kompjuterë të lidhur me internet, mjedise të gjelbëruara etj. Çdo fakultet ka bibliotekën përkatëse, laboratorë dhe mjedise për zhvillimin e praktikave profesionale. Vetëm për studentët janë krijuar mbi 100 poste interneti.

Universiteti “Fan S. Noli” ka mjedise për mësim në 5 ndërtesa, me një sipërfaqe prej 14377 m², si dhe mjedise çlodhëse e të gjelbëruara në secilën prej godinave.

a) Pajisjet;

Nr.	Teknologji kompjuterike	Njësia (në copë)
1.	Numri i PC për stafin akademik	137
2.	Numri i printerëve për stafin akademik	21
3.	Numri i PC për administratën	25
4.	Numri i printerëve për administratën	15
5.	Numri i PC për bibliotekën	26
6.	Nr. i PC për studentët (salla e kompjuterëve)	143
7.	Numri i printerëve për studentë	2
8.	Numri i PC për auditor mësimor	101
9.	Numri i projektorëve për auditor mësimor	46
10.	Numri i skanerëve	13
11.	Numri i fotokopjeve	20

Tabelë përmbledhëse

Nr.	Teknologji kompjuterike	Totali (në copë)
1.	PC	361
2.	Kompjuterë portative	36
3.	Printerë	49
4.	Skanerë	11

5.	Fotokopje	19
6.	Projektorë	56

b) Biblioteka.

Bibliotekat	Fondi i Librave	Numri i të regjistruarve	
		Studentë	Staf akademik
Fakultetit i Bujqësisë	2 210	108	22
Fakulteti i Ekonomisë	5 447	606	30
Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane	13 114	520	51
Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë	16 631	638	80
Gjithsej	37 402	1 872	183

X.SISTEMI I BRENDSHËM I SIGURIMIT TË CILËSISË

a) Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë;

Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë (NJBSC) u fut në strukturën e Universitetit si një njësi e re, pas miratimit që bëri Këshilli i Administrimit të Universitetit “Fan S. Noli” me Vendimin nr.2, datë 06.05.2008, si dhe në zbatim të nenit 59 të Ligjit “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, (i ndryshuar). Senati i Universitetit me Vendimin nr. 33 datë 17.11.2009 vendosi ngritjen e kësaj njësie si dhe përbërjen e saj. Ajo funksionon sipas kriterëve të përcaktuara në Nenet 61, 62 dhe 63 të Kreut VIII “Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë” të Statutit të Universitetit “Fan S. Noli”.

b) Funksionet e Njesisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë (NJBSC);

- NJBSC mbështet dhe ofron ekspertizë. Anëtarët e saj vizitojnë rregullisht çdo fakultet dhe çdo departament dhe ftohen nga ta që të ofrojnë ekspertizë në zhvillimin e proceseve përkatëse të sigurimit të cilësisë. Në veçanti, ekspertiza përqendrohet në zbatimin e mekanizmave për sigurimin e cilësisë në mësimdhënie, vlerësim dhe përfshirjen e studentëve në procesin e të nxënës.
- NJBSC bashkërendon komunikimin midis strukturave të ndryshme, veçanërisht kur procesi i delegohet fakulteteve ose kur ka një proces vlerësimi që është i organizuar nga Universiteti. Ky rol bashkërendues shtrihet në njësi të tjera në Universitet kur procesi ka të bëjë me zhvillimin e personelit dhe mbledhjen/analizën e të dhënave institucionale.
- NJSBC interpreton detyrimet kombëtare dhe evropiane të sigurimit të cilësisë, në mënyrë që t'i përshtatë ato në kontekstin institucional. Kështu, anëtarët e SC-së garantojnë që këto detyrime kombëtare dhe evropiane të njihen dhe të përfshihen nga universiteti.
- NJBSC monitoron duke ofruar udhëzime, duke mbledhur informacione dhe duke evidentuar probleme të cilat i përcjell në njësitë përgjegjëse për zgjidhje.
- NJBSC administron, organizon dhe përgatit vizita të vlerësimit të jashtëm ose fton ekspertë të jashtëm për të trajnuar stafin që merret me vlerësimin e brendshëm.

c) Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë.

Vlerësimi i Brendshëm menaxhohet nga Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë. Ajo ka si qëllim kryesor të monitorojë aktivitetin e sigurimit të cilësisë në universitet dhe të bashkërendojë komunikimin mes tij dhe institucioneve të vlerësimit të jashtëm që përcaktojnë kriteret e cilësisë në Arsimin e Lartë Shqiptar.

XI. ANALIZA SWOT E UNIVERSITETIT “FAN S. NOLI”

Grupi i punës identifikoi fuqitë, dobësitë, shanset dhe kërcënimet e Universitetit duke e përmbledhur si më poshtë:

Pikat e forta të brendshme potenciale	Pikat e dobëta të brendshme potenciale
1. Tradita dhe përvoja e gjatë e Universitetit, për një periudhë mbi 45-vjeçare; 2. Programe akademike bashkëkohore, kurrikula të veçanta në përputhje me prioritetet e zhvillimit të rajonit kërkesës së tregut dhe më gjërë; 3. Shkalla e lartë e kualifikimit të stafit akademik të brendshëm dhe atij mbështetës; 4. Staf akademik me moshë relativisht të re i predispozuar për të ndërrmarë dhe çuar deri në fund nisma me karakter akademik; 5. Mjedise dhe infrastrukturë bashkëkohore për një zhvillim normal të punës mësimore dhe kërkimore-shkencore, përdorimi me efektivitet i pajisjeve audiovizive, laboratorëve dhe bibliotekave për zhvillimin e mësimi dhe veprimtarive të tjera; 6. Rezultatet ekzistuese të mësimdhënies dhe përvoja e mirë që ofrojnë elementet bazë të kërkuara për programet e konsoliduara të nivelit të parë dhe të nivelit të dytë në hartimin dhe përmirësimin e programeve të reja; 7. Lidhjet e ngushta të Universitetit tonë me Universitetet homologe brenda dhe jashtë vendit kanë mundësuar jo vetëm krijimin e kushteve për kualifikimin dhe shkëmbimin e eksperiencës së stafit akademik por edhe bashkëpunim në drejtim të realizimit të programeve të studimit;	1. Rrënia e numrit të pranimeve; 2. Nevojë për përfshirje më të madhe dhe ndërgjegjësim të studentëve për rolin që luajnë në sigurimin e cilësisë së veprimtarisë akademike; 3. Rritja e bashkëpunimit me institucione të tjera palë të interesit; 4. Mungesa e një tregu të gjërë punësimi në nivel rajonal, mungesa e të dhënave mbi punësimet në nivel rajonal e më gjerë krijojnë vështirësi në orientimin e programeve të studimit dhe në përcaktimin e kuotave për çdo program; 5. Rritja e rolit të këshillimit të karrierës në secilin program. Përfshirja e studentëve sidomos atyre të ciklit të dytë në veprimtarinë kërkimore shkencore le për të dëshiruar. Ende nuk është gjetur pika e duhur e takimit të kërkimit shkencor me mësimdhënien. Kërkimet shkencore të anëtarëve të stafit akademik pavarësisht se janë të lavdërueshme si për nga sasia edhe për nga cilësia nuk shihen gjithmonë me syrin e vënies së këtyre kërkimeve në funksion të mësimdhënies; 6. Mungesa e lidhjes dhe e baraspeshës së duhur mes mësimdhënies dhe kërkimit shkencor në UNIKO. 7. Mungesa e literaturës bashkëkohore në bibliotekë dhe mos shfrytëzimin e literaturës eksistuese nga studentët në shkallën e duhur;

8. Bashkëpunimi kombëtar e ndërkombëtar pjesëmarrja në projekte, dhe trajnime të ndryshme; 9. Organizimi i mirë i praktikave profesionale të studentëve tanë; 10. Eksistenca e EDE-së dhe baza materiale e saj favorizon punën mësimore-shkencore, kryerjen e praktikave profesionale por shërben njëkohësisht dhe si bazë prodhuese; 11. Sistemi i brendshëm i sigurimit të cilësisë. Cilësia e veprimtarisë së UNIKO, garantohej nëpërmjet një sistemi të brendshëm të përbërë nga strukturat organizative të Universitetit F. S. Noli dhe të Fakulteteve. Ngritja e sistemit të sigurimit të cilësisë të përbërë nga Grupet e Vlerësimit të Brendshëm të Cilësisë në të gjitha nivelet (departament, fakultet dhe rektorat); 12. Përfshirja e studentëve në vendimmarrje. Organizimi i studentëve nëpër Këshillat studentore, përfaqësimi i tyre në organet kolegjiale si Senati Akademik, përfshirja e studentëve në procesin e hartimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të programeve të studimit, organizimi i aktiviteteve të ndryshme studentore që nga seminare shkencore, aktivitete sportive etj janë procese të cilat ndikojnë në rolin aktiv të studentëve në procesin e vendimmarrjes; 13. Trasmetimi tek studentët i një informacioni cilësor dhe bashkëkohor në të gjitha disiplinat mësimore e lëndët me karakter teorik e praktik, duke synuar arritjen e kompetencave profesionale e personale, me qëllim përgatitjen e studentëve cilësorë, të aftë që të analizojnë dhe konkludojnë në mënyrë të pavarur, të debatojnë e të marrin vendime të sakta, të orientohen shpejt përballë tërësisë së informacioneve dhe specifikimeve të sektorëve e degëve ku ata specializohen; 14. Përvoja e fituar nga Qendrat e Ekselencës si njësi bazë, kërkimore dhe trajnuese;	8. Mungesa e pavarësisë financiare të fakulteteve; 9. Preference jo e lartë nga maturantët për disa programe studimi; 10. Cilësia e ulët e studenteve në hyrje dhe në përfundim të studimeve; 11. Të aplikohen rezultatet e përftuara nga studimi i tregut i kryer nga disa departamente, për përmirësimin e kurrikulave, ristrukturimin e programeve eksistuese apo të kryet aplikimi për çeljen e programeve të reja; 12. Digjitalizimi i materialeve të bibliotekave të Fakulteteve; 13. Duhet përmirësuar raporti pedagog-student dhe pedagog i brendshëm-pedagog i jashtëm; 14. Mungesa e një mjedisi të përshtatshëm sportiv; 15. Angazhim më i madh i stafit akademik në aktivitetet shkencore dhe botuese. Të nxitet dhe përkrahet stafi në hartimin e teksteve mësimore për studentët; 16. Mungesa e një strategjie në mbështetje të fushave të kërkimit të identifikuar si prioritete në planin e zhvillimit strategjik.
Si u përdorën pikat e forta në ngritjen e strategjive të uljes së rreziqeve dhe përmirësimit të pikave të dobëta.	Cilat janë startegjitë e mundshme në përmirësimin e pikave të dobëta të evidentuara

1. Stafi i Universitetit është duke punuar për të rritur bazën e studimit për të hapur programe të reja të ciklit të parë, të ciklit të dytë si dhe programe 2-vjeçare me karakter profesional; 2. Nxitja e mobiliteteve mësimdhënëse dhe trajnuese për stafin akademik; 3. Organizimi i konferencave studentore periodike; 4. Krijimi i një baze të dhënash për rrumbëzimin e lidhjeve me studentët e diplomuar; 5. Në vazhdim të aplikimit të projektit “Ristrukturimi i kurrikulave mbi bazën e kompetencave” synohet të përgatitet një manual i kompetencave të disiplinave bazë dhe konvergjente/ të integruara; 6. Organizimi i veprimtarive shkencore të mirë organizuara në formën e konferencave, seminareve shkencore periodike, ligjeratave të hapura, shkëmbim stafi etj; 7. Rritjeve e përfshirjes më të gjërë në projekte të reja dhe eksistuese pas trajnimeve të duhura;	1. Vënia e veprimtarisë kërkimore shkencore në dispozicion të palëve të interesuara në tregun e punës; 2. Intesifikimi i punës kërkimore dhe kualifikuese të stafit akademik nëpërmjet projekteve të kërkimit në kuadër të doktoraturës, botimeve të artikujve shkencorë në organe me autoritet shkencor si dhe pjesëmarrës në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare; 3. Rritja e kapaciteteve kërkuese të laboratorëve , mediatekës dhe bibliotekave të fakulteteve në funksion të mësimdhënies; 4. Konsolidimi i programeve ekzistuese në ciklin Bachelor duke e përmirësuar kurrikulën ekzistuese dhe njehësuar atë me kurrikulat e universiteteve të tjera brenda vendit dhe në rajon; 5. Ristrukturimi i programeve të ciklit të dytë Master Profesional duke ju përgjigjur kërkesave të ligjit të ri të arsimit të lart, i cili parashikon rritjen e numrit të krediteve nga 90 ECT në 120 ECT me synim përfshirjen e karakterit psiko-pedagogjik; 6. Ngritja e shkollave verore që do të shërbejnë formimit të vazhduar profesional të mësuesve. 7. Përpjekje për të gjetur projekte që mundësojnë pasurimin e bibliotekave; 8. Vazhdon të mbetet sfida përmirësimi i imazhit tek maturantët. Për këtë qëllim mendohet se do të ndihmonte promovimi i vazhdueshëm gjatë gjithë vitit dhe rritja e bashkëpunimit në nivel institucional; 9. Të ndryshojë strategjia e Universitetit në zonat rurale; 10. Të testohet tregu (anketa) dhe të zbulohen shkaqet objektive të ndryshimit të preferencave; 11. Hartimi i objektivave zhvillimore sipas katër fushave të Planit Strategjik në përmbushjen e rekomandimeve të lëna nga Bordi i Akreditimit në vendimin e akreditimit institucional.
--	--

Mundësitë e jashtme potenciale	Rreziqet e jashtme potenciale
1. Pozicioni gjeografik i Universitetit F. S. Noli. Vendndodhja gjeografike e Universitetit F. S. Noli si qendër universitare për gjithë rajonin juglindor të Shqipërisë dhe në kufti me dy shtete ballkanike ofron mundësi për përthithjen e studentëve të rajonit dhe më gjerë si dhe për shkëmbimi përvojash në fushën e edukimit dhe kërkimit shkencor. 2. Shanse për rritjen e bashkëpunimit të Fakulteteve me institucionet publike dhe private; 3. Kthimi i fakulteteve në qendra trajnimi për të gjithë specialitetet që ofrojnë; 4. Mundësia e dhënies të mbështetjes financiare nga organizma qeveritare për studentet me të mira në fakultete; 5. Përmirësimi dhe standardizimi i CV dhe syllabuseve; 6. Kualifikimi i vazhduar i stafit akademik mbi metodologjinë e projekteve, gjuhën e huaj, teknologjinë e informacionit, metodikën e mësimdhënies ka për qëllim përmirësimin e cilësisë së brendshme si dhe veprimtarisë akademike kërkimore, shkencore dhe mësimore të programeve të studimit; 7. Bashkëpunimi midis institucioneve të arsimit të lartë në vend dhe jashtë tij, përbën një mundësi për shkëmbim eksperience, ekspertize, informacioni, dijes, teknologjish dhe burimesh njerëzore, por njëkohësisht ajo shërben edhe si një mundësi për reflektim e përmirësim të vazhdueshëm; 8. Proceset integruese, projektet e përbashkëta në të cilat është përfshirë universiteti ynë, krijojnë mundësi të mëdha për zgjerimin e bashkëpunimit me institucione brenda e rajonit dhe më gjerë, në fushën e mësimdhënies e kërkimit shkencor; 9. Qendra e Karrierës në Universitet do të përmirësojë lidhjet e institucionit me	1. Ndryshimet e shpeshta të kuadrit ligjor; 2. Unifikimi i kurrikulave të programeve të njëjtta ose të përafërta me Universitete të tjera; 3. Domosdoshmëria e intensifikimit të burimeve të financimit; 4. Numri i ulët i studentëve që duan të frekuentojnë disa nga programet e studimit që ofron UNIKO; 5. Kërkesa aktuale jo e lartë nga tregu i punës; 6. Hapja në Universitetet e tjera të programeve të reja; 7. Ndryshimet demografike në përgjithësi që pas vitit 1990 dhe tendenca në rënie e ritmit të rritjes; 8. Tendenda në rritje e numrit të maturantëve për të gjetur mundësi punësimi dhe studimi jashtë vendit; 9. Vështirësi në rekrutimin e një stafi të kualifikuar; 10. Vendimmarrje e centralizuar; 11. Implementimi i një sistemi të qëndrueshëm menaxhimi për sigurimin e cilësisë në universitet përbën një domosdoshmëri për të ardhmen. Rritja e shkallës së demokratizimit të jetës universitare dhe implementimi i një autonomie reale si akademike ashtu edhe financiare e pashoqëruar me rregulla dhe procedura të miratuara si dhe me mjetet e kontrollit të tyre do të sillte vetëm anarshi dhe përkeqësim të gjëndjes; 12. Rritja e vazhdueshme e numrit të studentëve pa marrë në konsideratë kushtet infrastrukturore të fakultetit, përbën një kërcënim për të ardhmen pasi mungesa e hapësirave dhe mjediseve të punës për studentët ndikon drejtpërsëdrejti në cilësinë në dalje; 13. Mungesa e një tregu të gjerë punësimi në nivel rajonal, mungesa e të dhënave mbi

studentët, do të krijojë kushtet për ngritjen e një databaze për studentët dhe për punësimin e tyre;	punësimet në nivel rajonal e më gjerë krijojnë vështirësi në orientimin e programeve të studimit dhe në përcaktimin e kuotave në çdo program; 14. Mosndjekja e tregut të punës dhe e tendencës së zhvillimit të arsimit të lartë në Shqipëri rajon e më gjerë dhe mosreflektimi i ndryshimeve në filozofinë, strategjinë, menaxhimin e institucionit, kurrikulat programet e lëndëve dhe gjithë dokumentacionin ku mbështetet veprimtaria e Fakulteteve rrezikon të vendosë në vështirësi rritjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të institucionit;
Sa ndikim kanë mundësitë e jashtme potenciale në rritjen e cilësisë dhe përmirësimin e dobësive.	Strategji të shmangies së rreziqeve të jashtme potenciale
1. Një pjesë e dobësive të konstatuara që kanë lidhje me punën e stafit akademik dhe me përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në Universitet janë plotësisht të menaxhueshme nëpërmjet vendosjes së prioriteteve dhe me gatishmërinë e organeve drejtuese të Universitetit. Duke parë ndryshimet dhe përmirësimet e bëra si në infrastrukturë ashtu dhenë mënyrën e menaxhimit dhe drejtimit të institucionit stafi akademik dhe organet drejtuese kanë kualifikimet dhe eksperiencën për të bërë përmirësime përkatëse aty ku vihen re pika të dobëta; 2. Krijimi dhe konsolidimi i lidhjeve të qëndrueshme dhe dobiprurëse me institucione të tjera të ngjashme të arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit, me institucione kërkimore-shkencore të fushave përkatëse për trasmetimin, shkëmbimin dhe përfitimin e përvojës në mësimdhënie dhe kërkimin shkencor; 3. Miratimi i programeve të nivelit të dytë do të sjellë rritjen e cilësisë në studentët e programeve Bachelor dhe Master krahasimisht do të rrisë prurjet; 4. Mungesa e mundësive për të krijuar lidhje të teorisë me praktikën për të pajisur studentët me aftësi praktike;	1. Konkretizimi i bashkëpunimeve me fakultete dhe institucione të tjera kërkimore-shkencore të fushave përkatëse për trasmetim shkëmbim dhe përfitimin e përvojës në mësimdhënie dhe kërkimin shkencor; 2. Dhënie e bursave për studentët që frekuentojnë disa nga programet e studimit që ofron UNIKO; 3. Krijimi i një databaze të saktë të dhënash për punësimin e studentëve të diplomuar në vite në UNIKO; 4. Të bashkëpunohet me njësitë e tjera kryesore të Universitetit para propozimit për hapjen e programeve të reja; 5. Të rritet shkalla e bashkëpunimit me universitetet e tjera për të propozuar hapjen e programeve të reja të cilat nuk janë pjesë e Universitetit të tjerë;

